



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 329/5 prot.

Tiranë, më 27.7.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 673, datë 15.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 13.7.2023, është njoftuar vendimi nr. 673, datë 15.6.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 673, datë 15.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*) nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të: “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Zavalani*”,<sup>2</sup> ka referuar se:

- (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar vlerën e pasurisë në bashkëpronësi dhe burimin e krijimit të pasurive;*
- (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë \*.10.2017<sup>3</sup>, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani*”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>4</sup> për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Mirela Zavalani.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] *Komisioni çmon se lidhur me analizën financiare për gjithë periudhën e rivlerësimit, 2003 – 2016, ndonëse është konstatuar një pamjaftueshmëri financiare, pasi janë marrë në konsideratë të ardhurat nga qiradhënia dhe enfiteoza, shpenzimet e ndërtimit të kryera nga subjekti në periudhën 2004 – 2006, si dhe korrigjimet në shpenzimet e udhëtimit, ka rezultuar një balancë negative prej - 1.854.851 lekësh. Vlen të theksohet se nga ky bilanc i përgjithshëm negativ pamundësia financiare pas vitit 2007 – përgjatë periudhës që subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit – ka rezultuar në vetëm - 428.356 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër i referohet periudhës së mëhershme. Në këto kushte, trupi gjykues – bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit – nisur nga vlera e*

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë \*.8.2018.

<sup>3</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr.\*\*\*, datë \*.6.2021.

<sup>4</sup> Raporti i KLP-së, nr. \*\*\* prot., datë \*.3.2023.

*mungesës së burimeve financiare të ligjshme, të rezultuar edhe nga shpërndarja e saj ndër vite, e vlerëson atë të pamjaftueshme për të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit, duke mos e gjetur në këtë rast të aplikueshëm nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...].*

**3.2 Për kontrollin e figurës.** [...] Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që ky subjekt rivlerësimi të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se znj. Mirela Zavalani arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi të ketë pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar [...].

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e saj, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit [...].

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Mirela Zavalani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**6.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**7.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat

kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 673, datë 15.6.2023, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 673/2023 të Komisionit.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III.A Kontrolli i pasurisë**

10. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, ka plotësuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2003, dorëzuar në ILDKPKI në datën \*\*.9.2004, në cilësinë e Oficeres së Policisë Gjqësore. Prej nëntorit të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e prokurores, duke dorëzuar deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në këtë funksion në datën \*\*.1.2008 dhe në vijim deklaratat periodike vjetore për vitet 2007 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe Deklaratën "Vetting" (këtu e në vijim referuar si D.-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën \*\*.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet si në vijim:

**12. Pasuria: "Supermarket tregtim pjesë këmbimi + servis auto + godinë banimi", me sip. totale 634 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Patos, Fier**

12.1 Në D. - Vetting, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti, ka deklaruar: "Supermarket tregtim pjesë këmbimi + servis auto + godinë banimi, me sip. totale 634 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Patos, Fier, në bashkëpronësi të tij dhe të babait të tij me pjesë takuese 50%, me burim krijimi nga të ardhurat nga puna e prindërve dhe nga shitja e apartamentit të mëparshëm".

12.2 Në të njëjtën deklaratë, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka shpjeguar se: "... në këtë godinë ndodhet: (i) banesa prej 80 m<sup>2</sup> ku kam jetuar unë dhe bashkëshortja, M. Zavalani për 6 vjet pas martesë, pasi aktualisht aty nuk banon njeri; (ii) banesa 2+1 ku jeton aktualisht

familja e babait \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*, si dhe (iii) biznesi, i cili ka qenë i licencuar me nr. \*\*\*, si person fizik dhe NIPT \*\*\*, në emër të vëllait \*\*\*,\*\*.\*.\*. Pjesa e fitimit nga biznesi është ndarë çdo vit me marrëveshje verbale në 50% ose 40% ndërmjet meje (bashkëshortit të subjektit) dhe familjes së babait, duke qenë marrëdhënie gjinie e afërt”. Sipas rivlerësimit të ZVRPP-së Fier, vlera totale e objektit është llogaritur në shumën **11.295.000 lekë**<sup>5</sup>.

12.3 Në DV-2003, plotësuar në funksionin e Oficeres së Policisë Gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy pasuri, përkatësisht: (i) “Banesë private e përbërë prej 1 kuzhinë, 1 salloni dhe 1 dhomë gjumi, me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, në të njëjtën ndërtesë me banesën e prindërve të bashkëshortit, e përbërë gjithashtu nga 2 dhoma e 1 kuzhinë, me vlerë **3.500.000 lekë**, e ndërtuar në vitin 1998; dhe (ii) Dyqan për tregtimin e pjesëve auto dhe vajra lubrifikantë, i cili është në të njëjtën ndërtesë me banesën, me vlerë **7.000.000 lekë**, i ndërtuar në vitin 1998 nga vjehri dhe bashkëshorti”.

12.4 Në Deklaratën para Fillimit të Detyrës si prokurore në vitin 2007 (dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2008), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit supermarket dhe shtëpi banimi, me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, me vlerë **250.000 euro**, duke shpjeguar se trulli është marrë nga shteti, ndërsa objekti është ndërtuar ndër vite, prej vitit 1995 e në vazhdim, nga vjehri dhe bashkëshorti, me të ardhurat nga pagat dhe nga dyqani.

12.5 Në shpjegimet e dhëna, në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së datë \*.3.2016, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaron se: “Sqaroj se kjo banesë është ndërtuar ndër vite duke filluar nga viti 1995 e më tej. Ky objekt është bërë nga babai i bashkëshortit tim \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe bashkëshorti im \*\*\*,\*\*.\*.\*, me të ardhura të tyre familjare të krijuara ndër vite. Sqaroj se ky objekt është bërë para martesës sime dhe është në bashkëpronësi të \*\*\*,\*\*.\*.\*, vjehri dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*, bashkëshorti im”.

12.6 Në aktet e administruara në dosje të Komisionit, ndër të tjera, lidhur me këtë pasuri, gjendet e administruar dhe shkresa nr. \*\*\*,\*\*.\*.\* prot., datë \*.11.2022, e ASHK-së Fier, e cila ka përcjellë dosjen e plotë të përfitimit të pasurisë së paluajtshme “godinë me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>”, së bashku me formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e pasurisë, preventive/situacione punimesh etj. Në aktet bashkëlidhur dosjes gjenden edhe:

(i) Deklaratë noteriale me nr. \*\*\*,\*\*.\*.\* rep., nr. \*\*\*,\*\*.\*.\* kol., datë \*.2.2020, me deklarues subjektin e rivlerësimit, e cila deklaron se: “...nuk ka asnjë pretendim për këtë pronë dhe është dakord që kjo pronë të regjistrohet në emër të këtyre personave në mënyre individuale (\*\*\*,\*\*.\*.\*, \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*), pasi kjo pasuri është pasuri e investuar para martesë...”.

(ii) Deklaratë noteriale me nr. \*\*\*,\*\*.\*.\* rep., nr. \*\*\*,\*\*.\*.\* kol., datë \*.2.2020, me deklarues shtetasit \*\*\*,\*\*.\*.\*, \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*, të cilët deklarojnë se: “...mbi objektin në proces legalizimi, ne deklaruesit \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*, jemi dakord që procedurat e legalizimit dhe më pas regjistrimit në ASHK, Drejtoria Fier, të vazhdojnë dhe në emër të djalit tonë \*\*\*,\*\*.\*.\*, për arsye se edhe \*\*\*,\*\*.\*.\* ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti, por në periudhën që është bërë deklarimi nuk ka qenë në Shqipëri, për këtë arsye deklarimi është bërë prej \*\*\*,\*\*.\*.\*”.

12.7 Nisur nga kontradiktat më lart konstatuar, Komisioni në pyetësorin nr. 2, ndër të tjera, i ka kërkuar subjektit të saktësojë vlerën totale të investimit të pasurisë së sipërcituar, si dhe kontributin e saj financiar në këtë investim, periudhën e saktë të fillimit dhe të përfundimit të

<sup>5</sup> Vlera e rivlerësuar e objektit nga ana e ZVRPP-së Fier është llogaritur në shumën 11.295.000 lekë, sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor datë \*.12.2006, për pasurinë me nr. \*\*\*,\*\*.\*.\*-ND, ZK \*\*\*, ndërtesë me sip. 251 m<sup>2</sup> në Patos, në bashkëpronësi të \*\*\*,\*\*.\*.\* dhe \*\*\*,\*\*.\*.\*, ku sipas shënimit, rivlerësimi është bërë në vitin 2012.

ndërtimit të pasurive të lartpërmendura, si dhe mospërputhjen që rezulton nga krahasimi i sipërfaqes dhe i vlerës së investimit/ndërtimit në shumën 11.295.000 lekë, të deklaruar në Deklaratën “Vetting”, krahasuar me sa është deklaruar në DV-në e vitit 2003 dhe 2007 (para fillimit të detyrës).

12.8 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Lidhur me ndërtimin e objektit “njësi” me sipërfaqe rreth 35 m<sup>2</sup>, familja e b/shortit deklaroi se pjesa më e madhe e punimeve është kryer në vitin 1997, e përfunduar në vitin 1998. Kostoja totale e ndërtimit për objektin “njësi” [me sipërfaqe rreth 34.46 m<sup>2</sup>], plus “shtëpi banimi” ka qenë jo më shumë se 2.000.000 lekë [deri në fund të vitit 1998]. ... Shuma totale e investuar për ndërtimin e sipërfaqes 167,04 m<sup>2</sup> të pjesës së mbetur të objektit “njësi”, ka qenë rreth 3.500.000 lekë...*

*Vlera e deklaruar e pasurive të paluajtshme në formularin A1 të deklaratës së personit që mbart detyrim për deklarim 2003, i referohet vlerës së tregut të menduar në atë kohë [pa iu referuar ndonjë të dhëne zyrtare të periudhës]... Lidhur me vlerën 250.000 euro të objektit [“banesë” + “njësi”], (DV-2007), ashtu sikundër ka ndodhur edhe në deklarimin e mëparshëm, si sqaruar më sipër, kam deklaruar vlerën e menduar të tregut.*

*Për deklarimet në deklaratën para fillimit të detyrës 2007, sqaroj - deklarimi në këtë deklaratë i pasurisë “njësi” plus “shtëpi banimi”, i referohet vetëm sipërfaqes së bazës së ndërtimit 251 m<sup>2</sup> [njollës së ndërtimit] sipas dokumentit Vërtetim nga Dokumentet Hipotekore, lëshuar nga ZRPP Fier, më datë \*\*.12.2006. Për deklarimet në Deklaratën e pasurisë Vetting, sqaroj - bashkëshorti, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar objektin “njësi” plus “shtëpi banimi” me sipërfaqe 634 m<sup>2</sup> sipas Akt-Kolaudimi i datës \*\*.10.2006.*

*Sikurse shpjeguar më lart, ky ndërtim ka filluar realisht me sheshimin e sipërfaqes së truallit, ndërtimit pjesor të shtëpisë në vitin 1994, pas pajisjes me dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e objektit në vitin 1993, ka vijuar ndërtimi i banesës dhe një pjesë e dyqanit [rreth 35 m<sup>2</sup>] në vitin 1995, duke përfunduar plotësisht ndërtimi i banesës në vitin 1998, ndërkohë që për banim është funksional vetëm kati i dytë deri aktualisht, pasi kati përdhe nuk është destinuar për banim. ... Ndërtimi i pjesës së mbetur të objektit “njësi” me sipërfaqe rreth 167,04 m<sup>2</sup>, ka vijuar në vitet 2004-2006. Rreth 45% e punimeve për ndërtimin e njësisë janë realizuar në gjysmën e parë të vitit 2004, po kaq janë edhe punimet e realizuara për vitin 2005, ndërsa diferenca prej 10% është finalizuar në fillim të vitit 2006. Shtesa prej 20.5 m<sup>2</sup> është ndërtuar deri në fund të vitit 2006”.*

12.8.1 Bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dhe një raport vlerësimi tekniko-ekonomik, të datës \*\*.12.2022, sipas të cilit kostoja totale e ndërtimit është përlllogaritur rreth **4.017.937 lekë**.

12.9 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar se: *[...] Nga sa më lart përshkruar, ka rezultuar se për ndërtimin e godinës së banimit dhe njësisë së shërbimit, prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej – 4.503.237 lekë, përgjatë periudhës 1994 – 1998. Duket se për ndërtimin e kryer përgjatë periudhës 2004 – 2006, prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për pjesën e tyre të kontributit. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, për pjesën e tyre të kontributit në këtë ndërtim, gjatë periudhës 2004 – 2006, kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej – 1.479.821 lekë [...].*

12.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar ndryshimin e analizës financiare, duke kërkuar rishikimin e disa prej zërave të saj, ku, përveç zbritjes në masën 8.83% të koston sipas EKB-së, duhet të zbriten nga kjo kosto edhe TVSH e pagueshme dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore<sup>6</sup>... Ndërsa në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2004-\*\*.10.2007, duhen konsideruar të ardhurat nga dyqani në shumën 400.000 lekë, në prill të vitit 2005, të deklaruar në DV-në përkatëse. Në konkluzion, subjekti ka pretenduar se nuk provohet që ajo me bashkëshortin të kenë kontribuar në ndërtimin e objektit. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës, deklaratën noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.6.2023, të lëshuar nga prindërit e bashkëshortit, të cilët kanë deklaruar se për investimin e kryer në periudhën 2004 – 2006, kanë përdorur shumat e marra hua nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*. (xhaxhai i subjektit) dhe kursimet e tyre.

12.11 Komisioni, nga shqyrtimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, ndër të tjera, ka vlerësuar se lidhur me përmbajtjen e deklaratës noteriale të qershorit 2023 (sipërcituar), deklarimi i personave të tjerë të lidhur, prindërve të bashkëshortit, është kontradiktor, krahasuar me deklarimin e tyre në deklaratën noteriale të vitit 2020, e për rrjedhojë, nuk sjell asnjë pasojë, duke mbetur në një nivel deklarativ. Ndërsa lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për vitet 2004-2006, Komisioni ka çmuar se, për sa i përket shpenzimit lidhur me kostot e ndërtimit në këtë periudhë, subjekti mbetet në një balancë negative prej -1.359.401 lekësh, duke e çmuar si fakt të pamjaftueshëm që të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, në aplikim të pikës 3, të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016.

**13. Komisioneri Publik**, në analizë të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”, në raport me deklaramet e dhëna në procesverbalin e ILDKPKI-së dhe ato të dhëna gjatë hetimit administrativ të Komisionit, duke i vlerësuar në tërësi me gjitha provat e administruara, çmon se, për qëllim të kontrollit të vërtetësisë dhe saktësisë të deklaramit të burimeve të ligjshme për pasurinë “*supermarket tregtim pjesë këmbimi + servis auto + godinë banimi*”, deklaramet e subjektit të rivlerësimit gjenden kontradiktore dhe jo të besueshme, duke mos qartësuar kështu faktet dhe rrethanat, objekt të barrës së provës, për sa argumentuar në vijim:

13.1 Në lidhje me sipërfaqen e objektit dhe koston e ndërtimit, subjekti i rivlerësimit në D.-Vetting, deklaroi një sipërfaqe totale prej 634 m<sup>2</sup> me vlerë **11.295.000 lekë**, deklarim ky i ndryshëm nga deklarimi i parë dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2003, ku deklarohet vetëm banesë private me sipërfaqe 80 m,<sup>2</sup> me vlerë **10.500.000 lekë** (banesë + dyqan). Po ashtu, në Deklaratën para Fillimit të Detyrës si prokurore, në vitin 2007, deklarohet pasuri e llojit *supermarket* dhe *shtëpi banimi*, me sipërfaqe 251 m,<sup>2</sup> me vlerë **250.000 euro**, ndërsa gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se pjesa e investuar deri në vitin 1998 është në shumën rreth **2.000.000 lekë** dhe se kostoja e pjesës së investuar për

---

<sup>6</sup> Subjekti pretendon se në zbatim të këtij parashikimi, nga kostoja e ndërtimit për çdo vit duhet zbritur 27,4% e TVSH-së dhe masa e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, që paguan shoqëria ndërtuese për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi apartament. Kontributi minimal i sigurimeve që duhet të paguajë shoqëria ndërtuese për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi sipas marrëveshjes është 1.274 lekë (918 + 356 = 1.274 lekë), në zbatim të parashikimeve të marrëveshjes në fjalë, kostoja e ndërtimit për periudhën 2004 – 2006 do të ulet në vlerën 3.399.541 lekë nga 3.803.952 lekë, përlogaritur nga Komisioni.

ndërtimin në vitet 2004-2006 ka qenë **rreth 3.500.000 lekë**. Ndërkohë, në raportin e vlerësimit tekniko-ekonomik, të datës \*\*.12.2022, vënë në dispozicion nga vetë subjekti, kostoja totale e ndërtimit përlllogaritet në vlerën rreth **4.017.937 lekë**.

13.2 Në lidhje me periudhën e ndërtimit, paraqiten disa versione jo të qarta, pasi subjekti i rivlerësimit në D.-Vetting deklaroi *ndërtimin përpara martesës* (korrik 1999)<sup>7</sup> dhe në deklarimin e parë, dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2003, e deklaroi të *ndërtuar në vitin 1998*, ndërsa në Deklaratën para Fillimit të Detyrës si prokurore, në vitin 2007, e deklaroi të *ndërtuar ndër vite, prej vitit 1995 e në vazhdim*. Gjatë hetimit administrativ<sup>8</sup> deklarohet se *ndërtimi ka filluar në vitin 1994, më tej ka vijuar ndërtimi i 2 kateve të banesës dhe i një pjese të dyqanit prej 35 m<sup>2</sup> nga viti 1995 e deri në vitin 1998<sup>9</sup>, ka vijuar të ndërtohet në vitet 2004 – 2006, përkatësisht 45%, 45% dhe 10% e punimeve*. Ndërkohë, në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë \*\*.3.2016, deklarohet se *është ndërtuar ndër vite duke filluar nga viti 1995 e më tej, para martesës sime*. Në raportin e vlerësimit të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si periudhë investimi përcaktohen vitet 1994-2006.

13.3 Kontradikta konstatohen edhe në lidhje me burimet e përdorura për ndërtimin e kësaj pasurie, pasi subjekti i rivlerësimit në D.-Vetting deklaroi si burim të *ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortit dhe nga shitja e apartamentit të mëparshëm*, ndërsa në deklarimin e parë dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2003, deklarohet si *pasuri e krijuar nga vjehri dhe bashkëshorti*. Më tej, në Deklaratën para Fillimit të Detyrës si prokurore, në vitin 2007, subjekti deklaroi si *burim krijimi nga vjehri dhe bashkëshorti, me të ardhurat nga pagat dhe nga dyqani*. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë \*\*.3.2016, deklarohet: “... ky objekt është ndërtuar nga babai i bashkëshortit dhe bashkëshorti im, me të ardhurat e tyre familjare të krijuara ndër vite...”, ndërsa gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë, se një nga burimet e krijimit të pasurisë është edhe huaja në vlerën 3.000.000 lekë, marrë prej vjehrit të saj, z. \*\*\*.\*\*\*, nga xhaxhai i saj, z. \*\*\*.\*\*\*, përkatësisht në dy këste, një në vitin 2002 dhe një në vitin 2004<sup>10</sup>.

13.4 Në lidhje me kontributin në ndërtimin e kësaj pasurie, referuar deklaratës noteriale me nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2020, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe prindërit e tij deklarojnë se *djali i tyre (bashkëshorti i subjektit) ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti, fakt ky i deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën noteriale me nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.2.2020, ku deklarohet se: në këtë pasuri është investuar prej tyre përpara martesës së saj*. Ndërsa gjatë hetimit administrativ, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës një tjetër deklaratë noteriale, atë me nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.6.2023,

<sup>7</sup> Referuar certifikatës së martesës, datë \*\*.7.2020, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë lidhur martesë ligjore në datën \*\*.7.1999.

<sup>8</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit.

<sup>9</sup> Ndërtim ky që, referuar shpjegimeve të vjehrit të subjektit, është kryer konkretisht: (i) në vitin 1994 është ndërtuar 100% kati përdhe i banesës; (ii) në vitin 1995 është kryer rreth 20% e katit të parë të banesës; (iii) në vitin 1996 rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës; (iv) në vitin 1997 është kryer rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës dhe pjesa më e madhe e punimeve për njësinë; dhe (v) në vitin 1998 është kryer rreth 20% e punimeve të katit të parë të banesës dhe përfundimi i njësisë.

<sup>10</sup> Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.11.2005, sipas së cilës z. \*\*\*.\*\*\* ka marrë hua nga z. \*\*\*.\*\*\* vlerën prej 3.000.000 lekësh, përkatësisht 1.500.000 lekë, në datën \*\*.10.2002 dhe 1.500.000 lekë, në datën \*\*.6.2004, të cilat, referuar shpjegimeve të subjektit, janë depozituar prej bashkëshortit të saj në llogaritë e tij bankare.



nënshkruar nga personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortit të subjektit, të cilët deklarojnë: “*se kanë vijuar investimin në vitet 2004-2006, pa kontribut material nga djali i madh, \*\*\**”. Ndryshe nga përmbajta e kësaj deklarate noteriale, në D.-Vetting, bashkëshorti i subjektit deklaroi pronësinë në masën 50% të ndërtimit, sikundër dhe nga aktet e depozituara për legalizimin e kësaj pasurie, nga të cilat rezultoi se në lejen e ndërtimit të vitit 1996 dhe në lejen për dhënie të sheshit të ndërtimit të vitit 1995, në seksionin e investitorit të pasurisë, përpos emrit të vjehrrit të subjektit është vendosur edhe emri i bashkëshortit të subjektit.

13.5 Komisioneri Publik, për sa më sipër analizuar, vlerëson se si pasojë e deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, në raport me përmbajtjen e akteve të administruara, deklarimi i pasurisë, objekt analize, në Deklaratën “Vetting” gjendet i pasaktë dhe jo i besueshëm, pasi krijon pamundësi për të verifikuar se cilat ndër versionet e deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit apo përmbajtja e akteve të paraqitura prej tij, pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike në krijimin e pasurisë, periudhën e ndërtimit, vlerën e investimit, si dhe ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura. Në këto rrethana, Institucioni i Komisionerëve Publikë gjendet në pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, detyrim i përcaktuar nga neni D i aneksit të Kushtetutës.

13.6 Komisioneri Publik, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit, edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me kuadrin ligjor të zbatueshëm, vlerëson se, përveç sa është konstatuar (prej Komisionit), mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, në investimet e kryera në këtë pasuri për periudhën 2004-2006, rrethanat e rezultuara mbi kontradiksionin e vërejtur në deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur me të, dhe aktet e administruara duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së një konkluzioni të drejtë mbi besueshmërinë e subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, lidhur kjo me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve për koston dhe ligjshmërinë e burimeve të deklaruara të përdorura për ndërtimin e njësisë *supermarket + godinë banimi*.

13.7 Në përfundim të sa më sipër, nga analiza financiare e viteve 1.1.2004 - 31.10.2007, në gjendjen që janë aktet në dosje, do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e periudhës. Përveç sa është konstatuar nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë financiare në këtë periudhë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në analizën financiare duhen rishikuar edhe zërat e tjerë, si llogaritjet e Komisionit mbi shpenzimet e jetesës së subjektit dhe personave të lidhur me të për vitin 2007, referuar standardit të përdorur në jurisprudencën e deritanishme bazuar në korrespondencën e ILDKPKI-së me INSTAT-in, si dhe të ardhurat nga qiraja/fitimi i aktivitetit privat, sikundër do të trajtohet në vijim. Rishikimi i këtyre zërave do të thellonte diferencën negative përtej asaj të konstatuar nga Komisioni.

#### **14. Pasuria apartament banimi, sip. 78,6 m<sup>2</sup>, me adresë rr. “\*\*\*\*”, Tiranë**

14.1 Në D.-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament banimi nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, sip. 78.6, kati \*\*\*, godina \*\*, rr. “\*\*\*\*”, pall. “\*\*\*\*”, hyrja \*\*, ap. \*\*, hipotekuar në ZVRPP Tiranë, me nr. \*\*\*/2007. Ky apartament është blerë me kontratë shitblerje noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.6.2007, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 3.144.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burim krijimi: (a) kursimet ndër vite nga paga si Oficere e Policisë Gjyqësore;

(b) bursa nga Shkolla e Magjistraturës; (c) të ardhurat nga paga e bashkëshortit; (d) të ardhurat nga dyqani tregtim – pjesë këmbimi.

14.2 Në Deklaratën para Fillimit të Detyrës si prokurore<sup>11</sup> në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë *Apartament me sipërfaqe 78.6 m<sup>2</sup> në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë*, përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*.6.2007, nga pala shitëse shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit prej 3.144.000 lekë. Burimi i krijimit: (a) *kursime 1.000.000 lekë; (b) të ardhura nga supermarketi pjesë këmbimi, në shumën 1.500.000 lekë; (c) dhuratë nga prindërit e bashkëshortit, në shumën 700.000 lekë.*

14.3 Komisioni, në pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë mospërputhjen që rezulton midis burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie, të deklaruara në D.-Vetting dhe Deklaratën para Fillimit të Detyrës të vitit 2007. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...saktësoj se nuk ka ndryshim mes deklarimeve për burimin e ligjshëm, pasi kanalizohen nga dy burime: i) kursime nga të ardhurat nga pagat dhe ii) të ardhurat nga aktiviteti ekonomik, të dyja burime të ligjshme, të provuara me dokumentacion justifikues. Në deklaratën e pasurisë Vetting, nuk është shprehur specifikisht e ardhura me burim dhuratë nga prindërit e bashkëshortit në shumën 700.000 lekë, e cila, në fakt, buron kryesisht nga të ardhurat neto të aktivitetit [babai, nëna, vëllai i b/shortit, 21 vjeç në regjim të përbashkët familjar...”*.

(i) *Kursime në shumën 1.000.000 lekë. Në fakt, prej kursimeve nga të ardhurat nga pagat [në llogari bankare apo cash], janë përdorur realisht 1.700.000 lekë [jo 1.000.000 lekë, si deklaruar në DIPP 2007], ndërsa për (ii) të ardhura nga supermarketi në masën 1.500.000 lekë, diferenca 1.500.000 lekë, konsiston në dhuratën nga prindërit e b/shortit në shumën 700.000 lekë dhe 800.000 lekë, të ardhura nga aktiviteti [prej të cilave 400.000 lekë janë depozituar në llogarinë time ... në \*\*\*\* Bank ShA, më \*\*.4.2005, dhe 400.000 lekë janë të ardhura nga qiraja e vitit 2007, marrë deri në \*\* qershor 2007. Diferenca prej 280.000 lekë është marrë deri në momentin e emërimit tim në detyrë, ndërsa diferenca prej 70.000 lekë nga qiraja, është marrë në fund të vitit 2007.”*

14.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar se: [...] *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë në analizë, në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, krahasuar me atë Vetting, në të cilën nuk është deklaruar burimi nga dhurimi prej prindërve, në vlerën 700.000 lekë. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përfitimin nga ana e bashkëshortit të saj të dhurimit nga ana e babait të tij, të pjesës takuese nga të ardhurat nga qiradhënia e objektit në bashkëpronësi, dhe kjo nuk rezulton e provuar me dokumente të kohës. Duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, burimin e krijimit të depozitës së tij bankare. Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në analizë, prej – 70.789 lekë [...].*

<sup>11</sup> Referuar deklaratës para fillimit të detyrës më datë \*\*.11.2007.

14.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se pasaktësia e personit të lidhur në deklarin e burimit të krijimit të depozitës e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, nuk ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit. Bashkëshorti nuk ndodhet në kushtet e dhurimit të ndonjë pjese takuese të të ardhurave nga qiradhënia, pasi ai ka përfituar thjesht qira nga pjesa e tij takuese sipas kontratës respektive. Lidhur me shumën 700.000 lekë të dhuruar nga prindërit, subjekti ka referuar jurisprudencën e Kolegjit në rastin e pasaktësive në deklarime të pashoqëruara me pamjaftueshmëri, duke vlerësuar se ajo dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë në fjalë.

14.6 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *mbetet një pasaktësi, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesa financiare, për sa kohë burimi i krijimit rezulton i provuar me dokumentacion, si dhe për më tepër dhurimi rezulton i deklaruar në mënyrë të qartë në deklaratën e vitit 2007. Komisioni, duke mbajtur në vëmendje faktin se të ardhurat nga qiraja dhe enfiteoza janë të ardhura me burime të ligjshme, referuar kësaj marrëdhënie juridiko - civile, të provuara me dokumentacion – përpos pasaktësisë së mosdeklarimit saktësisht të këtij burimi, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë financiare – vlerëson bindës shpjegimin e subjektit të rivlerësimit e, në përfundim, çmon se kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë në analizë. Lidhur me mosdeklarimin nga ana e personit të lidhur të burimit të krijimit të depozitës në DV- 2004, rezultati i njoftuar subjektit nuk ndryshon, duke e klasifikuar atë si një pasaktësi, e cila, e pashoqëruar me mungesë të burimit të ligjshëm, nuk e ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit [...].*

**15. Komisioneri Publik,** në analizë të akteve të administruara, lidhur me pasurinë apartament banimi, të ndodhur në Tiranë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se në kontekstin e qëllimit të procesit të rivlerësimit, pasaktësitë e vërejtura në deklarime duhen vlerësuar në raport me analizën e përgjithshme të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Në këtë logjikë, aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, deklarinimet dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, janë të dhëna që krijojnë mospërputhje dhe paqartësi për sa i përket burimit real të krijimit të pasurisë. Kjo mënyrë deklarimi ndikon edhe në kontrollin e plotë dhe të saktë të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurisë, duke bërë që sjellja e subjektit në këtë rast, në raport me kontrollin e kriterit të pasurisë, të mos arrijë nivelin e besueshëm, sikurse parashikon neni 59, pika 1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016. Nisur nga ky arsyetim, lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e pasurisë *apartament*, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në dy çështje, krijimin e depozitës bankare në shumën 1.950.000 lekë, në vitin 2004, si dhe të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti i “*supermarketit tregtim pjesë këmbimi + servis auto*”, në Patos.

**16. Lidhur me depozitën bankare,** nga hetimi administrativ ka rezultuar se shuma prej 1.950.000 lekë është depozituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë \*\*\* Bank në datën \*\*.6.2004. Kjo depozitë është deklaruar prej bashkëshortit të subjektit në DV- 2004, pa deklaruar burimin e krijimit të saj. Nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar posedim të kursimeve në *cash* në DV-2003, Komisioni ka analizuar mundësitë e krijimit të kësaj depozite me të ardhurat e periudhës \*\*.1.2004 – \*\*.6.2004. Konstatohet se në këtë analizë, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të periudhës në fjalë edhe shumën 1.500.000 lekë, hua e marrë nga vjehri i subjektit prej xhaxhait të saj. Sikundër kemi përmendur edhe më sipër, kjo hua është deklaruar nga

subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, duke deklaruar se për krijimin e depozitës prej 1.950.000 lekë është përdorur dhe shuma prej 1.500.000 lekë, hua e marrë me qëllim përfundimin e ndërtimit të pasurisë *supermarket + godinë banimi* në Patos, Fier<sup>12</sup>.

16.1 Për këto arsye, Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e ligjshme të depozitës bankare, deklaruar si një nga burimet e përdorura për blerjen e pasurisë *apartament banimi* të ndodhur në Tiranë.

17. *Mbi burimin e deklaruar “të ardhura nga supermarketi...”*. Në D.-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, *të ardhura nga dyqani në shumën totale 7.440.000 lekë, për vitet 2003 – dhjetor 2015*.

17.1 Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në D.-Vetting, në përshkrimin e pasurisë (*supermarket tregtim pjesë këmbimi + servis auto + godinë banimi*), ndër të tjera, ka deklaruar, se: *“...pjesa e fitimit nga biznesi është ndarë çdo vit me marrëveshje verbale ndërmjet meje dhe familjes së babait, në 50% ose 40% sipas rastit dhe nevojave, duke qenë marrëdhënie gjinie të afërt (babë e bir)”*.

17.2 *Në deklaratat periodike vjetore 2004-2015*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar të ardhura nga aktiviteti në shumën 5.360.000 lekë<sup>13</sup>, deklaruar si: *“të ardhura nga dyqani, pjesë këmbimi”*.

17.3 Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, në datën \*.3.2016, pasi subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion provues për të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore nga ky aktivitet, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“... në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga ana ime ndër vite sqaroj se nuk kam ndonjë dokumentacion vërtetues, pasi ka qenë biznes i vogël, i cili ka ofruar edhe shërbime të ndryshme për automjete dhe sipas fitimeve është bërë ndarja me marrëveshje midis bashkëshortit dhe familjarëve të tij”*.

17.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“... bashkëshorti im, \*\*\*,\*\*, për vitet 2007 – 2015, ka përfiturar të ardhura nga dhënia me qira e objektit ..., në bashkëpronësi të tij dhe z. \*\*\*,\*\* (babai i bashkëshortit), sipas kontratës noteriale të qirasë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*.12.2006, lidhur me Personin Fizik “\*\*\*,\*\*”, me Nipt \*\*\*, me adresë \*\*\* Patos, Fier, me objekt aktiviteti: “Servis pjesë këmbimi automjetesh, vajra lubrifikantë”. Të ardhurat e përfituara nga qiraja sipas kontratës noteriale të sipërcituar, janë deklaruar rregullisht në DIPV-të vjetore”. Për këtë qëllim, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e qirasë*

<sup>12</sup> Për më tepër mbetet i paqartë transaksioni në fjalë dhe përdorimi i kësaj shume, dhënë në formë huaje, për krijimin e depozitës bankare në emër të bashkëshortit të subjektit, duke tejkaluar qëllimin e dhënies së saj.

<sup>13</sup> Respektivisht: (i) Në DV- 2004, të ardhura në shumën 1.500.000 lekë; (ii) në DV-2005, të ardhura në shumën 1.200.000 lekë; (iii) në DV-2007 (para fillimit të detyrës), të ardhura në shumën 680.000 lekë, si dhe në DV-2007 të ardhura në shumën 70.000 lekë; (iv) në DV-2008, të ardhura në shumën 500.000 lekë, në DV-2009 të ardhura në shumën 300.000 lekë; (v) në DV- 2010, të ardhura në shumën 250.000 lekë; (vi) në DV-2011, të ardhura në shumën 350.000 lekë; (vii) në DV-2012, të ardhura në shumën 150.000 lekë; (viii) në DV-2013, të ardhura në shumën 160.000 lekë; (ix) në DV-2015, të ardhura në shumën 200.000 lekë.

me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2006, ku rezulton se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e qiradhënësit, *zotërues i pjesës prej 1/2 të pjesë takuese të pasurisë objekt kontrate*, i ka dhënë me qira vëllait të tij, Person Fizik \*\*\*.\*\*\*, dyqan me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Patos, Fier, me një afat 10-vjeçar, kundrejt vlerës totale prej 3.000.000 lekë bruto, për të gjithë afatin kohor. Sipas kontratës, vlera e qirasë do të parapaguhej, për vitin e parë 750.000 lekë, për vitin e dytë 500.000 lekë dhe për vitet në vazhdim në dakordësi mes palëve, por jo më pak se 150.000 lekë në vit.

17.5 Komisioni, nisur nga fakti i konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shuma të ndryshme të përfituara *nga të ardhurat nga dyqani*, referuar pyetësorit nr. 1 dhe D.-Vetting, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor, që provon shumën totale (neto), të të ardhurave nga ky aktivitet privat, duke specifikuar mënyrën dhe kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave, për çdo vit<sup>14</sup>. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, nga momenti i regjistrimit të aktivitetit të vëllait të bashkëshortit të saj e deri në fund të vitit 2006, fitimet e aktivitetit janë ndarë në dakordësi mes vëllezërve. Më pas, pas largimit nga banesa e përbashkët, ata kanë nënshkruar kontratën e qirasë.

17.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe një deklaratë noteriale të lëshuar nga babai i bashkëshortit të saj, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2022, në të cilën deklarohet se deri në momentin e largimit të djalit të tij nga banesa e përbashkët, në vitin 2007, ai ka përfutur të ardhura nga fitimi i aktivitetit tregtar të regjistruar në emër të z. \*\*\*.\*\*\*, në mënyrë proporcionale, si pjesë e bashkësisë familjare. Ndërsa, pas largimit nga banesa e përbashkët, në vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka përfutur tërësisht të ardhurat nga dhënia me qira e ambientit në të cilin ushtrohej aktiviteti - pasuri kjo në bashkëpronësi të tyre.

17.7 DRT Fier, me shkresën nr. \*\*\*, datë \*\*.1.2022, ka konfirmuar për Komisionin xhiron dhe fitimin pas tatimit për tatimpaguesin \*\*\*.\*\*\*, për vitet 2004-2015, nga ku rezulton se për vitet 2004 – 2006, është deklaruar vetëm xhiro në shumat 1.800.000-2.300.000 lekë, pa reflektuar fitim nga aktiviteti, ndërsa për vitet 2008-2015, fitimi rezulton në vlerat nga 17.803 lekë në 409.902 lekë.

17.8 Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, në konsideratë të faktit që bashkëshorti i subjektit nuk e ka deklaruar ndër vite dhurimin e pjesës takuese të babait të tij nga të ardhurat nga qiradhënia, gjatë periudhës 2007 – 2015, si dhe nuk ka një dokumentacion të kohës për ta provuar atë, ka vlerësuar se pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ, duke konsideruar fillimisht në mesin e të ardhurave, vetëm pjesën e tij takuese prej 1/2 të të ardhurave nga qiradhënia, në shumën totale 1.330.000 lekë. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga fitimi i aktivitetit të kumatit të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, gjatë periudhës prill 2004 – 2006, Komisioni ka vlerësuar se mbeten në nivel deklarativ<sup>15</sup>.

---

<sup>14</sup> Po ashtu, Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me arsyet e mosdeklarimit në DIPP përkatëse të përfitimit të qirasë nga viti 2007 e në vijim, duke saktësuar dhe qartësuar shumën financiare për çdo vit, dhe po ashtu ka kërkuar dokumentacionin ligjor, që provon pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiradhënia, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. Nga aktet në dosje rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, më datë \*\*.11.2021, ka bërë një tërheqje për arsye të pagesës së tatimit në burim, në bazë të kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2006, qiradhënësi \*\*\*.\*\*\* dhe qiramarrësi \*\*\*.\*\*\*.

<sup>15</sup> Komisioni, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka arsyetuar se: [...] *Ndërsa, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga fitimi i aktivitetit të kumatit të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, përgjatë periudhës prill 2004 – 2006, nisur nga u shpreh më sipër lidhur me këtë pretendim, si dhe duke i konsideruar ekonomitë familjare të ndara me vëllain e bashkëshortit të subjektit, në emër (vetëm) të të cilit ekzistonte biznesi në fjalë, ato mbeten në nivel deklarativ. Komisioni mbërrin në këtë konkluzion për sa kohë: (i) nuk*

17.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar se ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga dyqani në deklaratat periodike vjetore, duke depozituar për herë të parë edhe dy akte të reja, të cilat, pavarësisht datës dhe të dhënave që pasqyrojnë, rezultojnë se nuk i janë bashkëlidhur D.-Vetting apo pyetësorëve të Komisionit gjatë hetimit administrativ, konkretisht:

(i) Shkresë e thjeshtë, kontratë huapërdorje për pasuri të paluajtshme, e datës \*\*.4.2004, lidhur midis bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huadhënësit, dhe vëllait të tij, në cilësinë e huamarrësit, ku, ndër të tjera, përcaktohet se: *“huadhënësi pjesën e tij takuese të pasurisë bie dakord t’ia lërë në përdorim pa shpërblim huamarrësit, për të ushtruar aktivitet privat, për të cilin është regjistruar si person fizik”*, si dhe;

(ii) Kontratë noteriale enfiteoze, me nr. \*\*\* kol., datë \*\*.2.2005, lidhur midis bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e enfiteozëdhënësit, dhe vëllait të tij, në cilësinë e enfiteozëmarrësit, ku, ndër të tjera, përcaktohet se: *“enfiteozëdhënësi pjesën e tij takuese të pasurisë, prej 1/2, vendos t’ia japë në enfiteozë enfiteozëmarrësit, me qëllim vijimin e ushtrimit të aktivitetit të servisit të automjeteve”*.

17.10 Komisioni, në përfundim të sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacioni i paraqitur, duke mbajtur në vëmendje faktin se të ardhurat nga qiraja dhe enfiteozat janë të ardhura me burime të ligjshme, referuar kësaj marrëdhënieje juridiko - civile, të provuara me dokumentacion – përpos pasaktësisë së mosdeklarimit saktësisht të këtij burimi, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë financiare – vlerëson bindës shpjegimin e subjektit të rivlerësimit e, në përfundim, çmon se kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë në analizë [...].*

17.11 Bazuar në këtë arsytim, Komisioni ka rishikuar analizën financiare, duke konsideruar vlerën e plotë të të ardhurave nga aktiviteti/qiraja, për periudhën 2005 e në vijim.

17.12 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të akteve të administruara në dosje, vëren se rezultojnë deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të ardhurat e deklaruara nga supermarketi, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi jo vetëm për pasuritë e paluajtshme, deklaruar nga subjekti në deklarimin e saj të parë para fillimit të detyrës, por edhe në vijim për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve. Kështu, nga aktet e administruara rezultojnë këto rrethana fakti:

(i) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore mbi shumën e të ardhurave të përfituara nuk përputhen me deklarimin e saj në D.-Vetting apo me aktet e paraqitura gjatë hetimit, deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2022, nënshkruar nga babai i bashkëshortit, e cila, në bazë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, është akt që merret me rezervë.

---

*ka ndonjë dokumentacion të kohës mbi ndonjë marrëveshje të mundshme mes palëve/vëllezërve mbi ndarjen e fitimit nga ky biznes, si dhe (ii) bashkëshorti i subjektit nuk ka rezultuar të ketë qenë ndonjëherë ortak në këtë aktivitet tregtar; (iii) Për më tepër që ka rezultuar se të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga ndarja e fitimeve të këtij aktiviteti, janë edhe më të larta edhe se vetë fitimet totale të realizuara, sipas bilanceve, nga ky aktivitet përgjatë periudhës prill 2004 – 2006. Në këto kushte duket se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të disponuara nga familja e subjektit, me burim të ligjshëm financiar [...].*

(ii) Subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja dhe ka vënë në dispozicion kontratën midis palëve (një prej tyre), vetëm në përgjigje të pyetësorit standard, edhe pse nga aktet rezultojnë se nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie ndër vite, edhe pasi është pyetur shprehimisht mbi këto të ardhura nga ILDKPKI-ja në vitin 2016.

(iii) Të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore me burim nga supermarketi rezultojnë më të larta se fitimet neto të aktivitetit, referuar konfirmimit të DRT-së Fier.

(iv) Nuk dokumentohet përfitimi i të ardhurës, duke mbetur në nivel deklarativ e ardhura faktike e përfituar nga aktiviteti, qoftë në formë ndarje fitimi apo qiraje. Në këtë kuadër mbetet e paqartë dhe jo e besueshme vlera e të ardhurave nga aktiviteti apo qiraja e përfituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që ai rezultojnë bashkëpronar i ligjshëm vetëm për 1/2 e pasurisë dhe mund të disponojë lirisht vetëm për këtë pjesë të pasurisë.

(v) Nga verifikimi i pasqyrave financiare të aktivitetit, depozituar pranë QKB-së, referuar bilanceve të publikuara për vitet 2012 dhe 2013, në zërin “qira ambienti”, nuk rezultojnë të jetë reflektuar shpenzimi i qirasë.

(vi) Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare në monedhën euro, në emër të vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, pranë \*\*\* Bank, rezultojnë se, në datën \*\*.11.2021, është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit shuma 2.546,43 euro, me përshkrimin: “\*\*\*.\*\*\* tërheqje për arsye të pagesës së tatimit në burim në bazë të kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2006, qiradhënësi \*\*\*.\*\*\*, qiramarrësi \*\*\*.\*\*\*”.

17.12.1 Në këto kushte, Komisioneri Publik çmon se deklaratimet kontradiktore të subjektit janë të tilla që në gjendjen që paraqiten aktet e administruara, nuk mundësojnë kalimin e nivelit të besueshmërisë dhe pranueshmërisë së këtyre të ardhurave, duke rezultuar në pamjaftueshmëri të ndjeshme financiare dhe duke vënë në diskutim kështu, edhe aplikimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit në mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara për rastin në fjalë. Duke përfunduar, çmojmë se faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit duhen rivlerësuar nga juridiksioni kontrollues i Kolegjit, në drejtim të arritjes së një konkluzioni të drejtë mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit. Ky vlerësim mbetet i nevojshëm, pasi do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të, që me të ardhura të ligjshme të mbulojë investimet në pasuri të paluajtshme deri në vitin 2007, si dhe shpenzimet dhe kursimet në vijim.

## **18. Mbi disa transaksione bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për vitet 2009-2013**

18.1 Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se \*\*\* Bank, me shkresën nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2021, ka konfirmuar llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga verifikimi i tyre rezultojnë se nga llogaria me nr. \*\*\*-USD-\*\*\*, në monedhën USD, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*\*, për periudhën \*\*.1.2009 - \*\*.10.2012, janë kryer disa derdhje në llogari nëpërmjet depozitimeve cash nga ky i fundit, depozitime që variojnë nga shumat 550 USD në 10.000 USD, që në total arrijnë shumën prej 59.020 USD. Këto shuma janë transferuar në favor të vëllait të tij, shtetasit \*\*\*.\*\*\*, me përshkrime të ndryshme si:

*“OBLIGATION”/“OBLIGATION FOR BROTHER”/“FUNDS TRANSFER”/“PERSONAL TRANSFER”/“GIFT”.*

18.2 Për këto transferta, referuar akteve në dosje dhe përmbajtjes së vendimit objekt ankimi nr. 673/2023, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë pyetur mbi qëllimin apo burimin e shumave të transferuara. Përfshirja e tyre në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, do të ndikonte drejtpërsëdrejti në pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme të tyre, me ndikim domethënës në rezultatet financiare të analizës së viteve respektive.

19. Si përfundim, Komisioneri Publik, në të tilla rrethana, brenda kompetencave të tij kushtetuese, vlerëson se shkaqet e ankimit në vlerësimin e kriterit të pasurisë do të duhet të gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit të çështjes në Kolegj, si organ rivlerësimi që Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për gjykimin përfundimtar të çështjes, bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

23. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 673, datë 15.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**